



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-23219/23 datë: 23.08.2023



Npi – 01/307 datë: 29.08.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 29.08.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 29.08.2023 (e martë) në ora 09:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Nga ZKF z.Bujar Ferati, Praiktikantja znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 25.04.2023, 29.05.2023, 23.06.2023, 04.07.2023.
2. Raporti buxhetor për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2023,
3. Propozim-Vendim për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
4. Prezantim i planit buxhetor 2024-2026,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023),
6. Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore.
7. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për Diskutim Publik),
8. Propozim-Vendim për rialokimin e mjeteve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës me përjashtim të pikës 8, sepse nuk kemi material për këtë pikë.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përshëndetje, për sa i përket kësaj pike, unë e kam pritë materialin nga drejtoritë, por nuk më kan sjellë material. Unë i kam shifrat se sa mjete financiare kanë tepruar por nuk kamë ndonjë kërkesë nga drejtoritë se ku duhet të shkojnë këto mjete. Unë jam që të shtyhet për mbledhje të Kuvendit, nëse do të kemi material.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë rekomandoj që kjo pikë të shtyhet, dhe që ti rekomandojmë ekzekutivit me e sjellë materialin në Kuvend.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë jam që ta hjekim këtë pikë sepse nuk kemi material, nëse vjen materiali në Kuvend e diskutojmë.

z.Përparim Ramusa; KPF-ja është bash për këtë punë me i analizuar mjetet e tepruara.

z.Bujar Ferati, ZKF; Proceduralisht nuk e di se si shkonë. Por nese kanë drejtorat material në Kuvend e diskutojmë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës pa pikën e 8 të rendit të ditës, “Propozim-Vendim për rialokimin e mjeteve”**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 25.04.2023, 29.05.2023, 23.06.2023, 04.07.2023.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalet nga mbledhjet e KPF-së të mbajtura më: 25.04.2023, 29.05.2023, 23.06.2023, dhe 04.07.2023.**

Pika 2

Raporti buxhetor për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Raporti për nga struktura është i njejtë d.m.th. për nga struktura është sipas standartit. Por ndryshojnë vetëm shifrat në raport. Bazën ligjore e kemi të njejtën. Të hyrat vetanake janë 61% në rritje, financim nga huamarrja nuk kemi. Shpenzimet janë 3,620 mijë euro, me 32% nga vlera totale e buxhetit. Në raport me alokimet 50.5% janë shpenzuar. Në vazhdim Bujari lexoi raportin me shifra sipas kategorive buxhetore (shih dokumentin). Nuk do të ndalem shumë sepse e keni lexuar, por i pres pyetjet e juaja nese ka.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për informatën, po flasim për shpenzimet buxhetore e asnjë drejtor nuk është prezent në mbledhje po them sepse kemi pyetje për ta. Mallra dhe shërbime janë shpenzuar vetëm 28%. Te arsimi paga e meditjeve vetëm 29% . Mallra dhe shërbime te shëndetësia i kemi 24% mendoj se e logjikshme është me i shpenzuar më shumë.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, pajtohem me parafolësin Përparimin, se realisht ky është një raport i shpenzimeve por kompetent janë drejtorat për me qenë prezent e me dhënë sqarime.

znj.Adelina Beqaj; Mendoj se raporti ka njëfar efekti se a janë hargjuar mjetet si duhet apo jo. Unë jamë për me votuar raportin, edhe për sa i përket transparencës ndaj qytetarit.

z.Lumni Amrushit; Përshëndetje, ka një mal me procedura për me ardhë deri te ky raport. Ne kishim mujt me diskutuar me drejtorat kompetent. Bujari e tregon vetëm çështjen e shifrave procedurale.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Një rekomandim për drejtorat që me qenë prezent dhe me dhënë sqarime në Kuvend.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Drejtorive, që të marrin pjesë në mbledhjen e Kuvendit më 31.09.2023 dhe të japin sqarime secili për pjesën e vet sipas kompetencave që i kanë.**

Pika 2

Propozim-Vendim për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; E kemi bazën ligjore në dokument. Mund të ju them se falja mund të bëhet nga 1 euro deri në 100 euro. Komplet tatim janë 394,283,68 euro në Komunën e Shtimes. Sipas shifrave 79.800 euro kanë me u falë për 798 persona.

z.Kadri Emini; Ndryshimi i ligjit është gabim i madhë. Po bëhet diskriminim sepse atij me 34 euro i falen e atij me 2000 euro tatim i falen 100 euro. Mirëpo unë jamë “për” për shkak të shtresës së popullësis që kanë nevojë.

z.Lumni Amrushit; Vendim i gabushëm është kur janë ngritë çmimet. Sa i përket atyre që kanë tatim mbi 2000 euro, ata sigurisht që kontribuojnë më shumë me tatiime.

z.Përparim Ramusa; ZKF ishe i saktë për me i falë 100 euro, nuk kemi arsye mos me votu këtë vendim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.**

Pika 4

Prezantim i planit buxhetor 2024-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E falenderoj Bujarin për angazhimin për ta përgaditur vendimin, edhe pse ka qenë në pushim. Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Te faqe 4 tabela e fundit shihet sa ka qenë dhe mund ta shikoni se sa janë shifrat (në vazhdim e lexoi tekstin me shifra në këtë tabelë).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kourumin prej 5 anëtarëve.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Planin Komunal Buxhetor 2024-2026. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Financa. Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Zyra për Informim.**

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë dhe sqaroi se duhet të ndryshohet baza ligjore sipas rekomandimit të MMPHI-së.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023)**

Pika 6

Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Nuk mund të votojmë sepse Fatmir Zymerin, e njohim por kandidaten tjetër Feride Qorrolli nuk e njohim fare. Rekomandoj që me shku në Kuvend pa Rekomandim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi ta ftoi Drejtoreshën e Arsimit, në mbledhjen e Kuvendit më datën 31.08.2023 me arsyetimin që të jep sqarime për anëtarët e propozuar të Komisionit.**

Pika 7

Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për Diskutim Publik)


Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë, meqenëse nuk ka diskutime po e qes në votim sepse kjo ka me shku në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Zyra për Informim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pikën 8 e kemi shty. Meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoi në ora 10:18h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

